

“EUROGREN” Sh.p.k
Pasqrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 – 18

EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2022

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	31,847	9,151
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	1,764,000	1,764,000
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	1,820,201	2,735,201
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	6,012,329	6,012,329
Inventarë	8	87,100	87,100
Shpenzime të shtyra	9	-	7,749
Total aktive afatshkurtra		9,715,477	10,615,530
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	18,456,721	18,456,721
Aktive afatgjata jomateriale	11	1,568,700	1,568,700
Kapitali i papaguar		1,494,000	1,494,000
Total aktive afatgjata		21,519,421	21,519,421
Total aktive		31,234,898	32,134,951
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	12	-	4,408
Detyrime tatimore	13	24,726	16,730
Parapagime	14	-	363,622
Të tjera detyrime	15	341,029	321,017
Total detyrime afatshkurtra		365,755	705,777
Detyrime afatgjata			
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	16	37,167,085	36,253,009
Provizione		152,398	152,398
Total detyrime afatgjata		37,319,483	36,405,407
Total detyrime		37,685,238	37,111,184
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	17	51,760,627	51,760,627
Humbje të mbartura		(56,736,860)	(55,959,990)
Rezultati i ushtrimit		(1,474,107)	(776,870)
Total kapitali		(6,450,340)	(4,976,233)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		31,234,898	32,134,951

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	1,160,000	2,484,000
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera		(1,002,075)	(600,743)
1) Të tjera shpenzime	19	(1,002,075)	(600,743)
Shpenzime të personelit	20	(1,150,662)	(840,240)
1) Paga dhe shpërblime		(986,000)	(720,000)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore		(164,662)	(120,240)
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime/të ardhura financiare neto	21	(481,370)	(1,819,887)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(2,128,035)	(2,509,651)
2) Fitime/(humbje) nga përkthimet valutore		1,646,665	689,764
Fitimi/(humbja) para tatimit		(1,474,107)	(776,870)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	-	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi/(humbja) e vitit		(1,474,107)	(776,870)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(1,474,107)	(776,870)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

EUROGREN Sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022


	Kapitali i nënshkruar	Humbje të mbartura	Fitim/(humbja) e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2021	51,760,627	(54,660,582)	(1,299,408)	(4,199,363)
Fitimi/(humbja) e vitit	-	-	(776,870)	(776,870)
Levizje përmes kapitalit		(1,299,408)	1,299,408	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2021	51,760,627	(55,959,990)	(776,870)	(4,976,233)
Fitimi/(humbja) e vitit	-	-	(1,474,107)	(1,474,107)
Levizje përmes kapitalit	-	(776,870)	776,870	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2022	51,760,627	(56,736,860)	(1,474,107)	(6,450,340)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 janë aprovuar nga administratori i EUROGREN Sh.p.k më 24.03.2023 dhe janë firmosur si më poshtë.

Z. Edmond MERSINI

Administrator



Mazars Sh.p.k

Hartues i Pasqyrave Financiare

mazars

Emin Duraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUI: K32123006W

EUROGREN Sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Shënime	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Rezultati i vitit ushtrimor	(1,474,107)	(776,870)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	844,992	1,819,887
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	-	-
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	922,749	17,253
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(360,035)	6,312
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	20,012	7,104
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(46,389)	1,073,686
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-	-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	69,085	(1,140,002)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	69,085	(1,140,002)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	22,696	(66,316)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	9,151	75,467
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 31,847	9,151

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

“Eurogren” sh.p.k është regjistruar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me vendim gjykatë të rrethit Tiranë Nr.11574 datë 01.05.1996 në përputhje me Ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë tregtare”, si edhe nga statuti i saj.

Ortakët e shoqërisë janë:

- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës që zotëron 29% të kapitalit;
- Z.Edmond Mersini që zotëron 23.68% të kapitalit;
- Z.Hasan Hafizi që zotëron 23.66% të kapitalit;
- Znj. Mirela Mula që zotëron 23.66% të kapitalit.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është prodhim, përpunim, tregtim, eksportim dhe importim të detaleve gjysëmfabrikate prej druri, të lëndëve drusore të gjithëfarlojshme të sharruar, artikujve të tornuar e të profiluar, makinerive të përpunimit të drurit, organizimit dhe kryerjes së shërbimit të transportit për mallrat e ndryshëm dhe pasagjerë, të ushqimit social etj.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. “Konferenca e Pezës”, Nd.73, H.1, Njësia nr.6, Tiranë. Ajo është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë me Kod Fiskal 3705911 dhe NIPT J61814077J.

Më 31 dhjetor 2022 shoqëria kishte 2 punonjës (31 dhjetor 2021: 2 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur.

Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e performancës.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2022	2021
Euro/LEK	114.23	120.76
USD/ LEK	107.05	106.54

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e performancës. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet.

Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e performancës janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali i nënshkruar

Kapitali i nënshkruar njihet me vlerën nominale. Kuotat (pjesët) e zotëruara nga ortakët e shoqërisë klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e performancës.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2022 dhe 2021 është si më poshtë:

Kategoria e Aktiveve	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Automjetet	Vlera e mbetur	20%
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20%

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata material (vazhdim)

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e performancës nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e performancës. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e performancës me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e performancës përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 është 0% (2021: 0%).

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.9. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Mjete monetare në bankë	31,847	9,151
Llogari rrjedhëse	31,847	9,151
	31,847	9,151

EUROGREN Sh.p.k
Shenimet e Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Vlerat janë në Lek)

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Klientë	17,071,674	17,071,674
Zhvierësim i llogarive të arkëtueshme	(15,307,674)	(15,307,674)
	<u>1,764,000</u>	<u>1,764,000</u>

Lëvizjet në zhvierësimin e të drejtave për arkëtim detajohen më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Gjendja më 1 janar	15,307,674	15,307,674
Rimarrje për vitin 2021	-	-
Zhvierësim për vitin 2021	-	-
Gjendja më 31 dhjetor	<u>15,307,674</u>	<u>15,307,674</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Të arkëtueshme tregtare nga Emped shpk	1,820,201	2,735,201
	<u>1,820,201</u>	<u>2,735,201</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Shteti – TVSH për tu marrë	36,734	36,734
Tatim fitimi	1,151,803	1,151,803
Të tjera	4,823,792	4,823,792
	<u>6,012,329</u>	<u>6,012,329</u>

8. Inventarë

Inventari i shoqërisë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Produkte dhe mallra	5,725,175	5,725,175
Të tjera gjendje inventari	87,100	87,100
Provizione për zhvierësim	(5,725,175)	(5,725,175)
	<u>87,100</u>	<u>87,100</u>

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra të shoqërisë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Shpenzime mirëmbajtje	-	7,749
	<u>-</u>	<u>7,749</u>

EUROGREN Sh.p.k

Shenimet e Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive afatgjata materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Automjetet	Mobilje orendi	Totali
<i>Kosto</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2020	4,138,600	11,743,604	23,780,759	1,052,859	446,072	41,161,894
Shtesa	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	4,138,600	11,743,604	23,780,759	1,052,859	446,072	41,161,894
Shtesa	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	4,138,600	11,743,604	23,780,759	1,052,859	446,072	41,161,894
<i>Amortizimi i akumuluar</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2020	-	4,313,266	17,354,558	696,308	341,041	22,705,173
Amortizimi i vitit	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	-	4,313,266	17,354,558	696,308	341,041	22,705,173
Amortizimi i vitit	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	-	4,313,266	17,354,558	696,308	341,041	22,705,173
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 dhjetor 2020	4,138,600	7,430,338	6,426,201	356,551	105,031	18,456,721
Gjendja më 31 dhjetor 2021	4,138,600	7,430,338	6,426,201	356,551	105,031	18,456,721
Gjendja më 31 dhjetor 2022	4,138,600	7,430,338	6,426,201	356,551	105,031	18,456,721

EUROGREN Sh.p.k
Shenimet e Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Vlerat janë në Lek)

11. Aktivet afatgjata jomateriale

	<u>AAJM</u>	<u>Total</u>
Me kosto		
Gjendja me 31 dhjetor 2021	4,980,000	4,980,000
Shtesa	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2022	4,980,000	4,980,000
Amortizimi		
Gjendja me 31 dhjetor 2021	3,411,300	3,411,300
Shtesa	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2022	3,411,300	3,411,300
Gjendja neto më 31 dhjetor 2021	1,568,700	1,568,700
Gjendja neto më 31 dhjetor 2022	1,568,700	1,568,700

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Furnitorë vendas	-	4,408
	-	4,408

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	23,426	16,730
Tatimin mbi te ardhurat personale	1,300	-
	24,726	16,730

14. Parapagime

Parapagime më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Parapagime të marra	-	363,622
	-	363,622

15. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Paga për t'u paguar	73,292	53,280
Debitorë dhe kreditorë të tjerë	267,737	267,737
	341,029	321,017

EUROGREN Sh.p.k
Shenimet e Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Vlerat janë në Lek)

16. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Hua nga ortakët	37,167,085	36,253,009
	<u>37,167,085</u>	<u>36,253,009</u>

17. Kapitali

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 51,760,627 i ndarë në 100 kuota.

Gjatë vitit 2022 nuk kanë ndodhur ndryshime në kompozimin e kapitalit të shoqërisë.

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>
Të ardhura nga qiraja	1,160,000	2,484,000
	<u>1,160,000</u>	<u>2,484,000</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në e Tatim Fitimit	
Shitje total të deklaruara në FDP-në e TVSH-së	1,160,000
Zbriten autofaturimet	-
	<u>1,160,000</u>
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	
Efekti nga kembimet valutore	1,646,665
Të ardhura nga interesat	-
	<u>2,806,665</u>

19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>
Taksa të ndryshme lokale	798,054	532,580
Energji Elektrike	64,676	2,880
Kamatvonesa	60,298	-
Konsulenca ekonomike dhe juridike	48,000	48,000
Mirëmbajtje dhe riparime	16,149	2,583
Shpenzime Administrative	8,800	8,800
Komisione bankare	6,098	5,900
	<u>1,002,075</u>	<u>600,743</u>

20. Shpenzime të personelit

EUROGREN Sh.p.k
Shenimet e Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Vlerat janë në Lek)

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Paga dhe shpërblime	986,000	720,000
Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	164,662	120,240
	1,150,662	840,240

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2022 është 2 punonjës (2021: 2 punonjës).

21. Shpenzime / të ardhura financiare neto

Shpenzimet financiare neto përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	(2,491,657)	(2,509,651)
Fitime/(humbje) nga përkthimet valutore	1,646,665	689,764
Te ardhura te tjera	363,622	-
	(481,370)	(1,819,887)

22. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin detajohet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Fitimi para tatimit	(1,474,107)	(776,870)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	2,551,955	2,509,651
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	60,298	-
Shpenzime interesash të panjohura	2,491,657	2,509,651
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	1,077,848	1,732,781
Fitimi tatimor	1,077,848	1,732,781
Tatim fitimi	-	-
Rezultati i ushtrimit	(1,474,107)	(776,870)

EUROGREN Sh.p.k
Shenimet e Pasqyrave Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Vlerat janë në Lek)

23. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Hasan Hafizi	13,096,167	12,781,690
Edmond Mersini	13,096,167	12,781,690
Mirela Mula	10,974,751	10,689,629
	<u>37,167,085</u>	<u>36,253,009</u>
	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Të arkëtueshme nga palët e lidhura		
Emped Shpk	1,820,201	2,735,201
	<u>1,820,201</u>	<u>2,735,201</u>

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Transaksionet		
Shitje		
Emped shpk	1,160,000	720,000
	<u>1,160,000</u>	<u>720,000</u>

24. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta.

Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 dhjetor 2022 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

25. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.